



## Shteti social

Republika është barazi. Barazinë e ka pikënisje: të gjitha qytetarët në të, pa kurrfarë dallimi, janë të barabartë. Ajo po ashtu ndërton mekanizma që garantojnë këtë barazi, vazhdimisht dhe pafundësisht. Kështu Republika barazinë e ka pikësynim.

Barazia nuk është thjeshtë barazi në shanse. Individualisht, dhe në aspektin grupor (qoftë ky i përkufizuar nga vendbanimi, shtresa shoqërore, përgatitja shkollore i prindërve e familjarëve, zakonisht të tria të ndërlidhura), ne i nënshtrohemi kushteve dhe rrethanave të ndryshme objektive. Ato natyrisht se janë të determinuara nga një zhvillim i ndryshëm historik. Si rrjedhojë, Republika angazhohet në përmirësimin produkteve të ndryshme të rrethanave të ndryshme. Republika angazhohet për barazi në rezultate. Republika është vetëm atëherë kur ajo bëhet barazi e mirëqenie për qytetarin.

Mirëqenia sociale nuk është një mekanizëm. Ajo është pjesë përbërëse e secilës politikë të Republikës. Ajo para së gjithash dhe mbi të gjitha bazohen në një shpërndarje të barabartë të pasurisë dhe e kushtëzon atë. Barazia në rezultate, në funksion të rritjes së mirëqenies dhe barazisë së gjithëmbarshme, nënkupton që ata që fitojnë më shumë dhe që jetojnë në kushte më të mira, ta bartin një përgjegjësi më të madhe karshi të mirës së përgjithshme. Sepse kushtet e mira të jetesës dhe mundësia më e madhe për të krijuar të ardhura më të mira familjare janë prodhim i po kësaj të mire të përgjithshme: këto vijnë nga pasuria e përgjithshme e cila është krijuar, akumuluar, mirëmbajtur dhe funksionalizuar nga një punë e bashkuar shoqërore. Pjesëmarrja e barabartë në pasurinë e përgjithshme është parakusht i kohezionit shoqëror. E shoqëria kohezive është parakusht i krijimit të pasurisë së përgjithshme, e si rrjedhojë edhe asaj individuale.

Mirëqenia, si rishpërndarje e pasurisë, përveç drejtësisë dhe barazisë sociale, e ka edhe racionalen e vet ekonomike. Ajo e mundëson dhe funksionalizon kërkesën agregate të përgjithshme. Është ekonomi që merr për bazë mbikëqyrjen dhe nxitjen e kërkesës, e jo vetëm ekonomi e ofertës. Sepse nuk mund të ketë ekonomi pa kërkesë, siç nuk mund të ketë Republikë pa shoqëri.

Republika për të qenë, duhet të bëhet shtet social. Ky shtet social është shtet i popullor: sepse është shtet që i shërben pikërisht atyre shtresave shoqërore që e kanë më së shumti në nevojë. Ky shtet punon që t'i punësojë të papunët, t'ua mbrojë të drejtat punëtorëve të pambrojtur, t'ua ofrojë arsimin e shëndetësinë të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, t'ua shpaguajë dhe mirënjoh pensionistëve kontributin për shoqërinë. Ky shtet e siguron shoqërinë, e zhdruk dallimin, marginalizimin e shtypjen, e barazon gruan, e nxjerrë nga mjerimi të varfrin, dhe u garanton qasje në të mirat sociale të gjithëve. Këtë e bën Republika dhe kështu bëhet Republika.



## 13. Mbrojtja sociale

Kosova është **vendi më i varfër në Evropë**. Rreth 48% e popullsisë së vendit tonë jeton nën kufirin e varfërisë (më pak 1.42 euro në ditë) ndërsa 18% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë së skajshme (më pak se 0.93) euro në ditë. Sipas të dhënave të dalta nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, 45 % e popullsisë është e papunë, ndërsa vetëm 10% e popullsisë së re punon.

Shtetasit e Kosovës, sa i përket shëndetit, **janë qytetarët më të pambrojtur në Evropë** dhe në rajon. Karshi problemeve që kanë të bëjnë me kualitetin, ndër problemet themelore që lidhen me arsimin janë shanset e pabarabarta për arsim, bashkëpunimi mes prindërve dhe shkollës, dhuna në shkollë, shitja dhe konsumimi i substancave narkotike, mungesa e kuadrit që merret me problemet sociale të nxënësve, masat preventive në fusha të ndryshme dhe një varg problemesh të tjera.

Sipas një studimi të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2011 për buxhetin e ekonomive familjare del se 38% e buxheteve të ekonomive familjare harxhohet për ushqim, 31% për banim, ndërsa

vetëm 1% për arsim. Kjo tregon që 70% e buxhetit të familjeve harxhohet për nevoja elementare të mbijetesës.

Gruaja në Kosovë shfrytëzohet në forma të ndryshme, që nga ndarja e detyrave në familje e deri tek shfrytëzimi në punë dhe dallimet në të ardhura për shkak të përkatësisë gjinore. Gratë fitojnë më pak, janë në rend të dytë për t'u shkolluar, janë më të varfra se meshkujt dhe kanë më pak pozita drejtuese publike e institucionale. Sa i përket trashëgimisë së pronës, në shumicën e rasteve gruaja vazhdon të jetë e përjashtuar, qoftë nga pasuria e prindërve të saj, qoftë nga pasuria e bashkëshortit, edhe atëherë kur ajo është e punësuar dhe kontribuon me të ardhurat e saj.

Rinia sot ka mungesë të arsimimit cilësor, përfaqësimi në jetën publike është i mangët, dhe i kufizuar. Qeveritë e mëparshme, por edhe e tanishmja, rininë e konsiderojnë çështje fushatash. Të rinjtë e Kosovës nuk kanë mundësi punësimi, ndërkohë që mungon edhe një strategji e punësimit sezonal, mungon lidhja në mes të universitetit, punëtorive të ndryshme dhe qeverisë.

Qytetarët e moshuar në Kosovë, mbi moshën 65 vjeçare, bëjnë pjesë në grupin e klasave më të diskriminuara të shoqërisë. Për qytetarët e moshuar mungojnë vendet ku ata mund të takohen, këshillohen për problemet me të cilat ballafaqohen, apo të mund të shoqërohen në rrugën për t'i realizuar detyrat dhe për t'i përmbushur nevojat që kanë. Një pjesë e tyre janë pa asnjë kujdes familjar dhe shoqëror.

Qëllim primar i politikës sociale të Lëvizjes VETËVENDOSJE! është përmirësimi i gjendjes sociale të grupeve të rrezikuara dhe të diskriminuara. Qëllim i gjerë i politikës sociale është integrimi i grupeve të rrezikuara, diskriminuara dhe lëna pas dore, gjë që siguron integrim të përgjithshëm dhe stabilitet shoqëror. Në këtë kuptim politika sociale, nënkupton vizionin e një shoqërie për sigurinë sociale dhe drejtësinë dhe duke u mbështetur në këtë vizion, përpjekjet dhe masat konkrete të shtetit.

Bartës të politikës sociale janë shteti si aktor kryesor, organizatat ekonomike, sindikatat, organizatat joqeveritare dhe komunitetet

fetare. Ne angazhohemi që të ketë një bashkëpunim mes të gjithë faktorëve që ndikojnë në politikën sociale, duke krijuar kushte për bashkëpunim dhe implementimin e një politike që siguron integrimin e grupeve të ndryshme të shoqërisë.

Qëllimet themelore të politikës sociale **duhet të garantohen me kushtetutë**. Në shumë vende të botës kushtetuta garanton minimumin jetik dhe një **jetë me dinjitet** për çdo qytetar. Një jetë me dinjitet definohet vetëm atëherë kur individët dhe grupet sociale kanë qasje në resurset materiale, shëndetësore, edukative, kulturore dhe sociale.

## INDEKSI I MJERIMIT NË BOTË

<b>KOSOVA</b>	9
Nepali	8
Namibia	7
Xhibuti	6
Turkmenistani	5
Bjellorusia	4
Burkina Faso	3
Liberia	2
Zimbabve	1

## Shërbimet sociale

Shërbimet sociale janë mekanizma të krijuar për identifikim si dhe eliminimin e faktorëve të rrezikut të cilët cenojnë ekzistencën dhe funksionimin normal të çdo njeriu ose bashkësie familjare/shoqërore në fazat dhe situatat e vështira të jetës. Ato garantojnë mbijetesën, rehabilitimin, daljen nga izolimi si dhe zhvillimin normal të secilit individ i cili shfaq nevojën për shërbime sociale, por sidomos ndihmon në solidaritet ata të cilët nuk kanë qasje në resurset e mjaftueshme materiale, edukative, arsimore, shëndetësore, apo dhe qasje në infrastrukturën zbatimëse dhe krijuese gjatë kohës së lirë.

Shërbimet që do të ofrohen përfshijnë përkujdesjen e drejtpërdrejtë sociale, këshillimin, ndihmën materiale dhe shërbime për familjen në nevojë. Çdo person ose familje që e konsideron veten të jetë në nevojë sipas dispozitave të këtij ligji ka të drejtë që t'i vlerësohen rrethanat nga qendra për punë sociale e vendit ku jeton, ose në të cilin gjendet, dhe t'i plotësohen këto nevoja nëse është e arsyeshme që qendra për punë sociale të veprojnë kështu, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, përfshirë shkallën e nevojës dhe ekzistimin e burimeve për përmbushjen e saj.

## Funksionalizimi i qendrave sociale

VETËVENDOSJE! përcakton se në mandatin e saj qeverisëse si prioritet do ta ketë organizimin e ri dhe funksionalizimin e qendrave sociale në bazë të legjislacionit aktual. Qendrat sociale do të ofrojnë shërbime të cilat do të ndahen në tri grupe kryesore:

Shërbimet primare janë shërbime që për qëllim kryesor kanë masat preventive të cilat japin kontributin e tyre për parandalimin e problemeve. Të gjitha qendrat sociale në Kosovë do të ofrojnë shërbime primare e këshilluese: për familje, të rinj dhe të moshuar.

Shërbimet Sekondare me të cilat nënkuptojmë shërbimet për qytetarët që kanë probleme konkrete si p.sh. fëmijë pa përkujdesje prindërore, fëmijë me sjellje asociale, vështirësitë e moshës së thyer ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë, dhe

Shërbimet terciare me të cilat nënkuptojmë shërbimet për qytetarët të cilët nuk kanë mundësi t'i plotësojnë nevojat biologjike, që nuk kanë strehë mbi kokë, që nuk kanë veshje, që janë të detyruar të largohen pa u përgatitur prej bashkësisë familjare, apo raste të tjera emergjente, me ç'rast ndihma nuk mund të shtyhet për ditën e nesërme.

Qendrat Sociale, gjatë mandatit të Lëvizjes VETËVENDOSJE! **do t'i garantojnë të gjithë qytetarët që i plotësojnë kushtet për ndihma sociale**, t'i marrin ato sipas legjislacionit aktual. Koha prej parashtrimit të kërkesës për ndihmë sociale deri tek implementimi i ndihmës sociale do të shkurtohet. Qytetarët që kanë vështirësi për shtruarjen e kërkesës për ndihmë sociale dhe sigurimin e dokumentacionit përkatës, do të këshillohen, orientohen dhe ndihmohen nga juristët për të përgatitur dokumentacionin për këtë çështje

Çdo qendër sociale e ka për detyrë të sigurojë një shërbim juridik të pavarur nga Qendra Sociale. Shërbimi Juridik ka për detyrë t'i ndihmojë të gjithë qytetarët që kanë nevojë për këshilla juridike të fushave të ndryshme, t'i këshillojë, t'i orientojë dhe, në raste të veçanta, edhe t'i shoqërojë drejt realizimit të të drejtave të tyre.

Lëvizja VETËVENDOSJE! në mandatin e saj qeverisës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do të shtojë numrin e vendeve në universitet për punonjësit socialë, do të përcaktojë kurrikulumin e studimeve në atë mënyrë që ai t'i përshtatet nevojave të shoqërisë për punë sociale, do të sigurojë që arsimimi i punonjësve socialë të lidhet ngushtë me praktikën në institucione shtetërore dhe private dhe do të sigurojë që punonjësit socialë të arsimohen dhe specializohen për të gjitha problemet sociale me të cilat ballafaqohet shoqëria në Kosovë.

Në vitin e parë të qeverisjes tonë do të projektohen konceptet për punën e qendrave për përkujdesjen e fëmijëve jetimë dhe fëmijëve pa përkujdesjen në fjalë. Vitin e dytë do të sigurohen mjetet e nevojshme, ndërsa në fillim të vitit të tretë do të fillojë puna e tyre.

VETËVENDOSJE! gjatë mandatit të saj qeverisë do të krijojë qendrën e parë rehabilituese për të rinj e cila qëllim primar ka punën pedagogjike me të rinjtë delinkuentë, shkollimin e tyre dhe integrimin në shoqëri. Kjo qendër, e përbërë nga pedagogë socialë, psikologë dhe punonjës socialë, në bashkëpunim me institucionet shkollore, ndërmarrjet ekonomike private dhe publike, do të ndikojë që të rinjtë me sjellje delinkuente të ndryshojnë sjelljet e tyre, të shkollohen dhe punësohen.

Ne synojmë që gjatë mandatit qeverisë të funksionalizojmë **pesë shtëpi për përkujdesje për të moshuarit** në qendrat më të mëdha të Kosovës. Qëllimi i këtyre qendrave do të jetë përkujdesja ndaj qytetarëve në moshë që nuk kanë asnjë mundësi tjetër për përkujdesje deri në perëndimin e jetës së tyre.

**Synimi ynë është që në Kosovën e shekullit XXI, asnjë qytetar të mos përballet me urinë.** Në qendrat kryesore të Kosovës do të hapen kuzhinat popullore të cilat do të sigurojnë mëngjesin, drekën dhe darkën për qytetarët që me forca të tyre nuk mund ta sigurojnë ushqimin. Qendrat Sociale do t'i japin vërtetimet se cilët qytetarë kanë nevojë për një mbështetje të tillë. Këto qendra do të organizohen në bashkëpunim me qendrat sociale, shoqërinë civile, organizatat humanitare dhe ndërmarrjet ekonomike të komunave ku ato hapen.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe me komunat, do të përcaktohet një fond për hapjen e tri qendrave socio-kulturore në secilën komunë, me ambiente të përshtatshme për aktivitete sociale, kulturore dhe sportive.

## Transformimet ligjore

Neni 25 i Kushtetutës garanton të drejtën për jetë, por jo të drejtën për një jetë me dinjitet. Neni 51 i Kushtetutës garanton mbrojtje shëndetësore, por mungon Ligji për sigurimet shëndetësore. Sipas Nenit 47, institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar sipas aftësive dhe nevojave të veçanta



të tij/saj, por nuk përcakton me ligj se si realizohen mundësitë e barabarta.

VETËVENDOSJE! në politikën e saj sociale në lidhje me legjisllacionin, angazhohet që Kushtetuta në parimet e saj të përgjithshme të krijojë kushtet për vënien e bazave ligjore që garantojnë siguri sociale, barazi, shanse të barabarta fillestare dhe përmes ligjeve përkatëse mundësi të implementimit të tyre drejtpërsëdrejti për çdo qytetar. Parimi themelor në këtë drejtim, i cili duhet të futet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është garantimi i të drejtës së çdo qytetari për të jetuar me dinjitet. Kjo nënkupton, mes tjerash, Ligjin për pensione, Ligjin për punë, përcaktimin e normave konkrete se çka nënkuptohet me krijimin e shanseve në arsim, mbrojtjen e fëmijëve, mosdiskriminimin në punë apo mbështetjen e familjes.

## **E drejta e transferit të pensioneve jashtë vendit**

Institucionet e Kosovës do të angazhohen që me të gjitha shtetet ku punojnë, jetojnë dhe veprojnë qytetarët e Republikës së Kosovës, të arrihen, respektivisht të ripërtërihen marrëveshjet bilaterale apo multilaterale mbi sigurimet shoqërore. Ligji mbi sigurimet shoqërore i Republikës së Kosovës duhet të përfshijë edhe mundësinë e transferimit (eksportimit) të përfitimeve jashtë vendit.

Të gjithë ata, të cilët kanë të drejtën e derdhjes së kontributeve në arkat e sigurimeve shoqërore të Kosovës, me çka ata kontribuojnë në konsolidimin e arkave të pensionit dhe ekonomisë vendore, duhet ta gëzojnë të drejtën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore, përfitime këto që mund të transferohen edhe jashtë vendit.





## 14. Shëndetësia

Sistemi shëndetësor në Kosovë vazhdon të jetë në gjendje të mjerueshme. Pacientët **janë të pakënaqur me shërbimet shëndetësore** në sektorin publik dhe shumë prej tyre orientohen në sektorin privat ose detyrohen të shkojnë për shërim jashtë vendit si pasojë e humbjes së besimit në institucionet vendore.

Alternativa e Lëvizjes VETËVENDOSJE! për shëndetësinë e koncepton atë si të **drejtën e cilitdo qytetar të Kosovës** që të ketë kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës dhe cilësor, pavarësisht mundësive të kufizuara financiare. Ne angazhohemi për një **sektor të fortë publik** i cili mund t'i përgjigjet nevojave reale të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim. Sektori privat shëndetësor do të mund të jetë komplementar me atë publik, e kjo do të çonte edhe në përmirësimin e sektorit privat.

Duke analizuar sistemin shëndetësor aktual, Lëvizja VETËVENDOSJE! ka përcaktuar pikat më problematike të këtij sektori si: **Financimi joadekuat i shëndetësisë, Menaxhimi i dobët i sistemit shëndetësor, Zhvillimi joadekuat i burimeve njerëzore në sektorin shëndetësor dhe Mungesa e një infrastrukture ligjore të mirëfilltë**

## Financimi

Nëse bazohemi në të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë që rezulton me 1,733,872 banorë, del se shpenzimet publike në shëndetësi për **kokë banori janë 51,09 euro**. Shqipëria për shërbimet shëndetësore shpenzon 241 euro për kokë banori. Sipas Lëvizjes VETËVENDOSJE! buxheti për shëndetësinë duhet të rritet në **në 144.18 euro (afërsisht 200% ngritje), apo në optimum prej 201,86 eurosh – 300% ngritje**. Ne do të angazhohemi mjetet të sigurohen nga buxheti i Kosovës, fondi i sigurimeve shëndetësore dhe sigurimet private shëndetësore.

Ne angazhohemi për **themelimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore** i cili do të ketë një **karakter tipik solidar**. Ky sistem do të jetë i planifikuar sipas 'modelit të Bismarkut', me ç'rast i punësuarit dhe punëdhënësi do të paguajnë nga 3% të pagës bruto të të punësuarit.

## Transformimi institucional

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për **rritjen e kapaciteteve të menaxhimit dhe monitorimit**, duke filluar që nga zgjedhja transparente e menaxherëve pa ndikime partiake dhe të grupeve të interesit. Do të bëjmë **dyfishimin e numrit të inspektorëve shëndetësorë**, duke garantuar edhe rritjen e buxhetit të brendshëm të Inspektoriatit Shëndetësor të Kosovës.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për **themelimin e Agjencisë Shtetërore të Shëndetësisë** – që në sistemin institucional do ta ketë statusin e personit juridik me status të veçantë. Nën ombrellën e AShSh-së do të përfshiheshin institucionet shëndetësore të tri niveleve: parësor, dytësor dhe tretësor.

**Sistemi Informativ Shëndetësor është një domosdoshmëri** për të zhvilluar politika reale shëndetësore dhe përmirësimin e menaxhmentit dhe shërbimeve mjekësore.

## Shërbimet shëndetësore

**Shërbimi primar** është **hallka e parë dhe kryesore** në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Do të **racionalizohet rrjeti i ambulancave** dhe shtëpive të shëndetit konform nevojave të qytetarëve. Do të rritet numri i personelit shëndetësor bazuar në këto standarde dhe do të bëhet pajisja e këtyre qendrave me pajisje adekuate për ofrimin e shërbimeve shëndetësore bazë.

**Përcaktimi i protokolleve standarde** të mjekimit dhe zbatimi i tyre në shërbimin primar është nevojë imediate për ngritjen e cilësisë. Ambulancat dhe qendrat e mjekësisë familjare do ta ruajnë subjektivitetin dhe autonominë e vet si nga ana menaxheriale ashtu edhe buxhetore, por Lëvizja VETËVENDOSJE! do të angazhohet që shërbimi parësor të jetë pjesë e sistemit shëndetësor që do të menaxhohet nga Agjencia Shtetërore e Shëndetësisë (AShSh).

Në Kosovë janë gjithsej 7 institucione shëndetësore, të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore të nivelit sekondar të shëndetësisë. Duke parë shpërndarjen gjeografike të këtyre spitaleve Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që të ketë **një riorganizim të këtyre spitaleve në aspektin e investimeve dhe resurseve humane**. Në bazë të këtyre nevojave do të ketë një strukturim korrekt të personelit mjekësor.

Shërbimet kryesore si anestezi i me mjekim intensiv dhe emergjenca, kirurgjia e përgjithshme, gjinekologjia, pediatria, mjekësia interne dhe shërbime të tjera të domosdoshme duhet të funksionojnë në secilin nga këto spitale. Lëvizja VETËVENDOSJE! do të angazhohet për **themelimin e Spitalit Rajonal të Prishtinës si institucion i nivelit sekondar**.

Në nivelin Terciar VETËVENDOSJE! vendos theksin në përmirësimin e sistemit të shkollimit mjekësor, universiteteve e klinikave universitare, e në të njëjtën kohë garantimin e cilësisë së diplomës, përmes një kontrolli rigoroz. Për këtë arsye ne angazhohemi për përcaktim të standardeve për edukimin e personelit shëndetësor në arsimin e lartë.

Për Lëvizjen VETËVENDOSJE! me rëndësi të veçantë do të mbetet investimi për profilet që mungojnë në këtë qendër si, kardiokirurgjia dhe funksionalizimi i qendrës diagnostike dhe terapeutike të onkologjisë. Në këtë mënyrë qytetarëve do t'u mundësohet qasja e lehtë në këto shërbime deficitare specialistike brenda Kosovës.

## Mbikëqyrja

Ofrimi i shërbimeve korrekte shëndetësore në të tri nivelet do të garantohet përmes ngritjes së strukturave **mbikëqyrëse permanente** për të luftuar të gjitha fenomenet e këqija. Në mënyrë që të shmangen konfliktet aktuale të interesit do të punohet për një ndarje më të qartë **të sektorit publik dhe atij privat**. Ne jemi të bindur se me ngritjen e kapaciteteve dhe strukturave në sektorin publik ky konflikt interesi do të ulet ndjeshëm.

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të shqyrtojë mundësinë që Shërbimet mbështetëse dhe logjistike, siç janë furnizimi me ushqim, pastrimi i ambienteve dhe i teshave, parkimi i veturave, siguria, mirëmbajtja e lulishteve, transporti etj. të kryhen nga ndërmarrjet publike të asocuara me shërbimin shëndetësor.

Parandalimi i sëmundjeve dhe krijimi i kushteve më të mira të jetesës, ngritja e vetëdijësimit qytetar për mbrojtjen e shëndetit, janë postulatet kryesore të strategjisë së mjekësisë preventive për të cilën angazhohemi. VETËVENDOSJE! planin strategjik të mjekësisë preventive do ta përqendrojë në mjekësinë e punës, mjekësinë shkollore, dhe mjekësinë familjare. Në kuadër të zhvillimit të programeve hulumtuese dhe luftimit të sëmundjeve akute dhe atyre kronike, VETËVENDOSJE! do të angazhohet **për themelimin e Institutit të Mjekësisë Preventive**.

IKShP, si qendra kryesore për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve dhe hulumtimin e faktorëve ambientalë që dëmtojnë shëndetin, luan rol edhe në promovimin e shëndetit dhe ka një rol të madh në këtë drejtim.

Do të organizohen fushatat e kontrollit higjienik dhe mjekësor të të gjithë nxënësve në të gjitha shkollat publike, një herë në muaj, kontrollit të çdo qytetari për sëmundjen e diabetit dhe kontrollit të secilës grua për kancerin e gjirit (mamografi), përmes klinikave lëvizëse që do të vizitojnë secilin fshat.

Nevojitet rishikimi i politikave të **licencimit të punëtorëve shëndetësorë**. Ne angazhohemi për monitorim **efektiv të edukimit specialistik**. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet procedurave që zbatohen gjatë edukimit specialistik përfshirë edhe cilësinë e mentorimit.

Lëvizja VETËVENDOSJE! në planin qeverisës ka për qëllim zbatimin e përpiktë të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë ashtu që odave t'iu sigurohet kompetenca që ta organizojnë edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve shëndetësorë.

## Farmacia

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që të gjithë qytetarëve t'u ofrohet **qasje e lehtë, çmim i arsyeshëm dhe cilësi e plotë** e të gjitha produkteve të nevojshme farmaceutike, gjithmonë duke iu referuar praktikave të mira të farmacisë, dhe duke pasur për bazë gjithmonë qasjen profesionale ndaj pacientit.

Ne do të angazhohemi për decentralizimin e sistemit publik të prokurimit në nivelin e sistemit sekondar dhe terciar, gjithnjë përmes AshSh. Duke qenë se barnat janë produkte të një rëndësie të veçantë, ne angazhohemi që shteti të jetë një **rregullator i çmimeve në tregun e barnave**, duke mbrojtur qytetarin. Masat që do të ndërmerim në këtë drejtim janë funksionalizimi i plotë i laboratorit për kontrollin e cilësisë së barnave. Themelimi i Komitetit për Barna dhe Terapi i përbërë nga profesionistët shëndetësorë që në mënyrë shkencore do të përcaktonin protokollin e trajtimit me barna

## Strategjia legislative për transformimin e sektorit të shëndetësisë

Lëvizja VETËVENDOSJE! zotohet për kalimin e **Ligjin për Sistemin Shëndetësor** me të cilin do të rregullohej i mbarë sistemi shëndetësor në Republikën e Kosovës, **Ligjin për Sigurime Shëndetësore** që do të rregullonte sistemin e financimit të shërbimeve shëndetësore, **Ligjin për Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Profesionistëve Shëndetësorë** me cilin do të rregullohej statusi i punëtorit shëndetësor si shërbyes publik dhe përgjegjësit në vendin e punës, **Ligjin për Sistemin Informativ Shëndetësor** që do të rregullonte mënyrën e bartjes së informatave, përpunimit dhe arkivimit të tyre dhe mbrojtjen konfidenciale të të dhënave individuale, **Ligjin për Mbrojtjen Shëndetësore Kombëtare** për t'i përkufizuar kushtet kryesore të mbrojtjes shëndetësore në nivel kombëtar, dhe **Ligjin për Qarkullimin e Produkteve Medicinale** me të cilin do të rregullohet qarkullimi i produkteve medicinale për të parandaluar çfarëdo monopoli dhe konkurrence të pandershme në tregun e produkteve medicinale.





## 15. Mbrojtja në raportet e punës

Që nga përfundimi i luftës, Kosova është duke u ballafaquar me një deficit në aspektin e punësimit dhe qëndrueshmërisë së tregut të punës në përgjithësi. Kosova me një kapacitet të popullsisë aktive (të aftë për punë) që tejkalon çdo mesatare në krahasim me vendet të tjera në rajon, por, bile edhe shumë shtete evropiane, **ka çdo të dytin qytetar të papunë**. Rezultati i gjithë këtij epilogu është varfëria e mjerimi. **48% e popullsisë jeton me më pak se 1,42€ në ditë, dhe 18% e popullsisë në varfëri ekstreme, me më pak se 0,93€ në ditë.**

Këtë gjendje e rëndon brishtësia e funksionimit të institucioneve ekzekutive dhe gjyqësore në aspektin e zbatimit të legjislacionit. Kur merret parasysh edhe niveli i mosorganizimit të punëtorëve mund të konkludojmë se **punëtorët janë krejtësisht të pambrojtur.**

Në këtë drejtim, Lëvizja VETËVENDOSJE! do të angazhohet për një **infrastrukturë ligjore e cila do të garantojë një ambient të sigurt dhe të dinjitetshëm për të punësuarit**. Në fokus të strategjisë legjislative të Lëvizjes VETËVENDOSJE! është avancimi i rregullimit të Ligjit të Punës si ligj bazik për rregullimin e të drejtave në punë. Në reformën legjislative do të përfshiheshin këto pika.

**Pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajsh do të mund të nga të dy prindërit.** Me këtë do të zbutet diskriminimi i gruas në tregun e punës, që është shkaktuar nga rregullimi momental i ligjit në fuqi.

**Orari prej 40 orëve paraqet maksimumin e kohëzgjatjes së orarit të detyruar,** me ç'rast puna shtesë nuk mund të ketë kohëzgjatje më tepër se 5 orë në javë për dy javë, brenda 3 muajve. Me sigurimin e standardeve bazë me të cilat sigurohet puna e dinjitetshme, do të sigurohet edhe efikasiteti dhe produktiviteti i të punësuarve.

Me rastin e ndërprerjes së punës pas skadimit të kontratës, Ligji i punës, në mungesë të fondit për të papunët, do të përcaktonte **pagesën e dy pagave me rastin e përfundimit të marrëdhënies.**

Lëvizja VETËVENDOSJE zotohet për **nivelizimin e pagave sipas rrezikshmërisë së punës deri më 20% sipas shkallës së rrezikshmërisë.**

Me qëllim të sistemimit të pagave sipas përvojës së punës, me ndryshimin e ligjit të punës do të **parashihet vlerësimi i beneficionit për përvojën e punës për çdo pesë vite me ngritje të pagës prej 5%,** duke kalkuluar indeksimin vjetor prej 0,5% të pagës.

Lëvizja VETËVENDOSJE! në alternativën e saj qeverisëse planifikon themelimin e **Këshillave Socialë në nivel ndërmarrje dhe sektori me bazë ligjore** (përfaqësimi i të punësuarve dhe punëdhënësve) në çdo ndërmarrje që ka mbi 10 punëtorë të punësuar. Me themelimin e këtyre këshillave do të sigurohej kultivimi i dialogut social në nivel ndërmarrje, i cili do të kontribuonte në lidhjen e Kontratave Kolektive në nivel të ndërmarrjes.

Lëvizja VETËVENDOSJE! përpos masave institucionale për luftimin e informalitetit, si metodë tjetër për forcimin e raporteve në marrëdhëniet e punës parasheh **subvencionimin progresiv tatimor për punëdhënësit që punësojnë punëtorë të rinj dhe ata ekzistues,** sipas numrit dhe statusit të ndërmarrjes.

Me një numër tejet të vogël të inspektorëve të punës (afro 58) është i pamundshëm inspektimi i afro 89,000 bizneseve. Si pasojë, më shumë se 65% e të punësuarve nuk kanë fare kontratë të punës, nuk paguhen kontributet pensionale dhe tatimi në të ardhura personale. Lëvizja VETËVENDOSJE konsideron se duhet të rritet buxheti i Inspektoratit të Punës. Ndërrimi i statusit të IPK-së, themelimi i tij si agjenci e pavarur dhe e udhëhequr në mënyrë të përbashkët me përfaqësues të të punësuarve, do të ndikonte në ngritjen e kualitetit inspektues.

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të punojë në miratimin e **Ligjit mbi punën vullnetare** për punë në dobi të përgjithshme, i cili do të parashihte stimulimin e qytetarit në aktivitete publike dhe shoqërore me qëllim të ngritjes së mirëqenies shoqërore në nivel vendi. Llogaritja e punës në dobi të përgjithshme në stazhin e punës dhe stimulime kreditore për persona që kryejnë punë në dobi të përgjithshme, do të ishte e drejtë ligjore e të gjithë atyre që do të kryenin punë vullnetare në dobi të përgjithshme.

VETËVENDOSJE! zotohet për **ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Organizim Sindikal në Kosovë**, i cili para së gjithash do të parashihte anëtarësimin e obliguar në organizatë sindikale të të punësuarve në ndërmarrje ku janë të anëtarësuar mbi 60% të punësuarve. Nisma legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Organizimin Sindikal do të parashihte edhe **mbrojtjen e veçantë për të punësuarit që merren me aktivitet sindikal** dhe të gjithë të punësuarve që janë anëtarë të shoqatës sindikale. Po ashtu, konsiderojmë se përcaktimi i ndërhyrjes apo ndalimit të së drejtës për organizim sindikal nga ana e punëdhënësit si vepër penale do të duhej të parashihet në nismën legislative.

Lëvizja VETËVENDOSJE! parashihet **themelimin e gjykatës së veçantë të punës**. Themelimi i Gjykatave të specializuara për konteste nga marrëdhënia e punës do të siguronte një trajtim të profilizuar të këtyre kontesteve, duke përgatitur dhe angazhuar gjyqtarë të profilizuar për zgjidhjen e lëndëve nga këto konteste.





## 16. Sistemi pensional

Sistemi pensional ekzistues në Kosovë është vendosur me rregulloren 2001/35 të UNMIK-ut, ndërsa Trusti i Kursimeve Pensionale ka filluar të mbledh kontribute në vitin 2002. Me vendosjen e këtij sistemi është bërë një prerje e menjëhershme në mes të dy formave të rregullimit të sistemit pensional, pra, duke bërë një tranzicion nga sistemi i gjeneratave në atë të vetëfinancimit dhe, kështu, duke lënë anash një gjeneratë të tërë të pensionistëve ekzistues.

Sistemi aktual pensional për këto vite **nuk është zhvilluar në mënyrë adekuate**, duke lënë të krijohet një monopol mbi kursimet pensionale në Kosovë dhe si i tillë ka rezultuar si joefikas në mbledhjen e kursimeve nacionale, ka shkaktuar humbje të vazhdueshme të vlerës së parasë së investuar, dhe nuk ka qenë në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Sistemi aktual është i ndarë në tri shtyllat e përshkruara më poshtë:

**Shtylla I – Pensioni bazë:** i paguhet çdo personi mbi 65 vjeç. Barra për buxhetin është 64 milionë euro. **Shtylla II - Kursimet obligative:** kontribute 5% nga i punësuari dhe 5% nga punëdhënësi dhe **Shtylla III - Kursimet vullnetare:** çdo individ ose punëdhënës mund të kontribuojë edhe 10% shtesë nga investimi obligativ me përfitime tatimore.

Lëvizja VETËVENDOSJE! synon ta ndërtojë një sistem pensional të qëndrueshëm, solidar dhe të barabartë, që **garanton pensione stabile** dhe të mjaftueshme për gjeneratat e ardhshme, por në të njëjtën kohë **përkujdeset për pensionistët**. Me këtë alternativë synohet të krijohet një sistem pensional që do gjeneronte kursime nacionale të mjaftueshme për të krijuar një sistem të qëndrueshëm pensional, do përkujdesej për pensionistët ekzistues duke krijuar një periudhë transitore prej një forme pensionale në tjetrën, dhe në fund fare do krijonte fonde shtese për stimulimin e sektorëve dhe industrive strategjike dhe do stimulonte edhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Kontributi shtesë do të aplikohet në tregun e punës nga **5%+5% në 8%+8%**, me ç'rast diferenca prej 3% + 3% ose shuma shtesë mbi 80 milion euro në baza vjetore do transferohej në shtyllën e parë për të financuar pensionistët ekzistues. Lëvizja VETËVENDOSJE! do të themelojë fondin pensional që do vendoset në shtyllën I dhe do ketë për synim të lehtësojë barrën fiskale të pensioneve në buxhet dhe njëkohësisht të rrisë nivelin e pensioneve.

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të **hap tregun pensional obligativ**. Lejimi i konkurrencës në shtyllën e dytë do sigurojë një efikasitet të shtuar si në menaxhimin e kursimeve pensionale por edhe në rritjen e shumës së grumbulluar. Ky hap do sigurojë ardhjen e investitorëve të huaj, ngritjen e kapaciteteve për grumbullimin e kontributeve pensionale, diversifikimin e riskut të asociuar me mbajtjen e të gjitha kursimeve pensionale në një fond pensional dhe, në fund, edhe aftësinë e të njëjtave për të menaxhuar kursimet pensionale.

Një përqindje e fondeve që do të mbliidhen nga Fondet Pensionale **do të investohen në Kosovë** në asete strategjike kombëtare si Trepçë, KEK, apo PTK. 3% duhet të jetë kthimi i garantuar për kursimet e qytetarëve nga fondet pensionale që operojnë në shtyllën e dytë, pra atë obligative. Nëse ky kthim nuk arrihet, i njëjti duhet të refundohet nga kapitali i kompanisë.

Listat e pensionistëve aktualë **duhet të pastrohen**. Ato duhet të përfshijnë vetëm ata individë që duhet të marrin pensione nga shtylla bazë pensionale e Kosovës. Në bazë të përvojës së punës për secilin pensionist do të duhet të llogaritet pensioni i tij, në mënyrë të shkallëzuar (5–10, 10–15, 15–20, 20 e më shumë).

Këto hapa e bëjnë të mundshme që në vitin e parë të qeverisjes së VETËVENDOSJE!-s, pensioni bazik do të bëhet 90 euro, derisa ai kontributdhënës, 175 euro. Ndërsa deri në fund të mandatit të parë pensioni bazik do të arrijë shumën prej 150 euro, derisa ai kontribut dhënës, 280 euro.







## 17. Mërgata

Një vlerësim i përgjithshëm është se jashtë Kosovës jetojnë rreth 800.000 qytetarë. Konsiderohet se rreth 30% e popullsisë së Kosovës jetojnë jashtë vendit. Mërgata shqiptare ka pasë një rol të rëndësishëm në mbijetesën politike dhe ekonomike të shqiptarëve në ish Jugosllavi. Ajo u kthye jo vetëm në strehë, për të përndjekurit politikë, gazetarët, artistët e shkrimtarët, por financoi për dekada me radhë ekzistencën ekonomike, politike dhe arsimin. Gjatë luftës në Kosovë, mërgata dha një mbështetje të fuqishme, duke vënë në shërbim resurse njerëzore dhe materiale.

Në periudhën prej vitit 2004 deri në vitin 2008 emigracioni i Kosovës ka dërguar në Kosovë 2.4 miliardë euro, pra më shumë mjete se të gjitha ndihmat ndërkombëtare për zhvillim (2.3 miliardë euro). Është për t'u theksuar se 25% e të gjitha bizneseve në Kosovë janë themeluar me fonde të pjesërishtme ose të plota të krijuara nga puna jashtë vendit. 19.6% e familjeve kosovare pranojnë remitanca nga mërgata.

Lëvizja VETËVENDOSJE! konsideron se mërgata **shqiptare është pjesë e popullit të Kosovës** e cila për dekada me radhë mundësoi luftën çlirimtare kundër Serbisë prandaj. Ne konsiderojmë që edhe sot mërgata e Kosovës ka një potencial shumë të madh për të qenë

pjesë aktive e shtetndërtimit dhe zhvillimit të Kosovës. Punonjësit, paratë e Kosovës, e madje edhe njerëzit më të arsimuar të Kosovës, profesionistët më të zotë të saj, sot ndodhen kryesisht në mërgim. Ne angazhohemi që mërgata e Kosovës të kthehet nga objekti në subjekt si në vendin e prejardhjes ashtu edhe në vendin ku jeton dhe punon, duke krijuar kushte që ajo t'i mbrojë interesat e saj, të ndihmojë në zhvillimin dhe ndërtimin e vendit dhe të çmohet për punën e saj.

Lëvizja VETËVENDOSJE! e çmon mërgatën si pjesë vitale të popullit shqiptar dhe angazhohet që asaj t'i garantohen të gjitha të drejtat që u garantohen qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vend.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që të krijohen kushte të nevojshme, **ashtu që qytetarët tanë mërgimtarë në ditën e zgjedhjeve të mund të votojnë** në objektet fizike të përfaqësive diplomatike (ambasada e konsullata) .

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që të sigurohen **vendet në parlament** për përfaqësuesit e mërgatës. Me përfaqësim politik mërgata e Kosovës mund t'i realizojë të drejtat e saj dhe t'i mbrojë interesat si një pjesë e popullsisë së Kosovës me halle të veçanta.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për **pjesëmarrje në institucione** të përfaqësuesve të mërgatës. Ne nuk do e kufizojmë përfaqësimin e mërgatës vetëm në pozitën e kreut të ministrisë së mërgatës.

Lëvizja VETËVENDOSJE! synon të krijojë **lehtësime për investime** nga ana e mërgatës në Kosovë. Lëvizja VETËVENDOSJE! do ta krijojë një zyrë të veçantë në Ministrinë e Tregtisë që do të merret vetëm me mërgimtarët tanë që dëshirojnë të investojnë në Kosovë për t'i udhëzuar ata dhe për t'i ndihmuar me lehtësime për nisjen e biznesit.

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të angazhohet që në Kosovë të ftohen ekspertë të fushave të ndryshme, të njohur si të tillë edhe në vendet ku jetojnë, dhe që atyre t'iu krijohen kushte për punë dhe ekzistencë në Kosovë, duke i dhënë Kosovës shanse të reja për zhvillim, duke i shtuar kapitalin e diturisë dhe duke i lidhur njerëzit e saj të mërgatës me Kosovën. Po ashtu VETËVENDOSJE! do të ofrojë mundësi

për studentët e mërgatës që gjatë vitit të vijnë në Kosovë dhe të angazhohen si praktikantë në fushat e tyre të studimit për ta përfituar përvojën praktike.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për një rregullim të tillë ligjor i cili **ndalon plaçkitjen e mërgimtarëve si nga sigurimet e automjeteve** ashtu edhe nga shteti.

Shtetësia e dyfishtë është gjithashtu një e drejtë të cilën Lëvizja VETËVENDOSJE! konsideron se duhet ta përdorin të gjithë qytetarët e Kosovës, sipas kontekstit të vendit ku kanë mërguar. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për një dialog ndërshtetëror i cili do ta kishte për qëllim përmirësimin e pozitës strukturore të mërgatës në vendet në të cilat ajo jeton. Përmes dialogut ndërshtetëror ne angazhohemi të krijojmë kushte të favorshme për integrimin e qytetarëve të Kosovës në vendet ku ata jetojnë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që qytetarët e Kosovës që jetojnë në Kosovë të mos ekstradohen jashtë vendit kundër vullnetit të tyre, për t'u dënuar për veprat të cilat i kanë bërë në mërgim. Në rastet e tilla shtetet e huaja mund të bëjnë kallëzim penal pranë vendit tonë. Gjyqësia e Kosovës do t'i trajtojë rastet dhe do t'i dënojë kryesisht e veprave sipas ligjeve vendëse dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo praktikë zbatohet në shumë shtete të tjera dhe nuk ka asnjë arsye të mos zbatohet edhe në Kosovë.





## 18. Zhvillimi kulturor, politikat për kulturën dhe trashëgiminë

Lëvizja VETËVENDOSJE! e **konsideron kulturën si pjesë të pandashme** të shoqërisë. Përvojat e mira kulturore i sjellin cilësi jetës, inspirimit e reflektimit, si dhe krijojnë ndjenjën e përkatësisë. Të gjitha moshat në secilin vendbanim ku jetojnë duhet të kenë qasje të lehtë dhe të barabartë në përvojat kulturore dhe artistike, si dhe ta kenë mundësinë e shprehjes së tyre përmes artit dhe kulturës.

Ne angazhohemi që ta **ruajmë dhe promovojmë trashëgiminë kulturore të Kosovës**. Ne e konsiderojmë këtë trashëgimi si pjesë të pandashme të historisë së popullit të Kosovës, dhe angazhohemi për qasje të barabartë të të gjithëve në të. Trashëgimia kulturore e Kosovës i takon të gjithëve që jetojnë në Kosovë. Lëvizja VETËVENDOSJE! kundërshton të gjitha tendencat politike për ndarjen fizike të trashëgimisë sonë kulturore nga pjesa tjetër e Kosovës, si dhe ato për uzurpimin e saj nga Serbia.

Ne angazhohemi që ta **afirmojmë kulturën kombëtare të shqiptarëve** si shumicë e popullsisë së Kosovës, duke qenë të vetëdijshëm se në Kosovë jetojnë edhe pakicat kombëtare, për të cilat angazhohemi që ta **gëzojnë autonominë maksimale kulturore**. Njëkohësisht ne angazhohemi ta dërgojmë Kosovën **drejt integritit të plotë kulturor me Shqipërinë**, të vetëdijshëm se e kemi një kulturë kombëtare.

**Artistët e lirë janë bartësit e zhvillimit të artit** në një shoqëri. Për këtë arsye, atyre duhet t'u krijohen kushte për të krijuar. Në këtë mënyrë artistët që angazhohen në lëminë e artit dhe krijimtarisë artistike për një kohë ta gëzojnë statutin e artistit të lirë aktiv. Si rezultat, do të kenë mundësi të veprojnë ngjashëm me një person juridik dhe të kenë benefite specifike, por dhe obligime. Krijimi i instrumenteve për zbatimin e **Ligjit për të Drejtat Autoriale** është prioritet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, sa i përket fushës së kulturës.

**Agjencia Kombëtare për Zhvillimin e Artit do të krijohej për zhvillimin e artit**, duke e përkrahur një mori aktivitete artistike: prej teatrit e deri te muzika, letërsisë deri te vallëzimi, fotografisë deri te arti dixhital, karnevaleve deri te artizanatet. AKZHA do të kujdesej për shpërndarjen e fondeve nga Buxheti i Kosovës (dhe donatorë të tjerë) për ta sjellë artin skenik, pamor e muzikor më afër shoqërisë.

Për t'u kthyer besimi te juritë profesioniste, Lëvizja VETËVENDOSJE! planifikon që Ministria e Kulturës ta krijojë një listë të standardeve minimale për dhënien e granteve dhe shpërblimeve të ndryshme në aktivitetet e sponsorizuara tërësisht apo pjesërisht nga ministria. Një prej standardeve minimale, për shembull, do të jetë edhe minimumi i numrit të anëtarëve në juritë shpërblyese, ku **juria nuk do të mund t'i ketë më pak se 21 veta**. Juritë më të mëdha do ta vështirësonin në masë të madhe mundësinë e influencimit të rezultatit të votimit në mënyrë të paligjshme nga ndonjë faktor i jashtëm.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, në çdo institucion të arsimit do të zhvillohen aktivitete artistike në fusha të ndryshme artistike, si: teatër, film/video, këndim/muzikë, pikturë etj. Televizionet kombëtare, me ligj të veçantë, do të duhej të **prodhonin sasi të**

**caktuara të veprave audiovizuale**, si film artistik, film dokumentar, dramë televizive, serial etj. Kjo do të ndikonte që p.sh. televizionet kombëtare të merrnin pjesë në bashkëprodhimin e filmave artistikë, në mënyrë që ta përmbushin kuotën e caktuar, gjë që do ta nxiste e zhvillonte industrinë e filmit në Kosovë.

Ne mendojmë që duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë **arsimit dhe përkrahjes së shkrimtarëve të rinj**, në mënyrë që niveli i cilësisë së arteve skenike në përgjithësi të ngrihet në nivel vleror. Ministria e Kulturës do të krijojë hapat strategjikë për ta ndihmuar **librin e krijuesin dhe, rrjedhimisht, edhe kthimin e -vëmendjes së publikut** përmes angazhimit të Bibliotekës Kombëtare për arkivimin e ekzemplarëve të librit të botuar, reklamimit të botimeve në mediat e shkruara dhe vizive pa detyrim tarifor, organizimit të promovimeve e tribunave me lexues në të gjitha qendrat, stimulimit të asociacioneve e shkrimtarëve për organizimin e manifestimeve mbarëkombëtare dhe për dhënien e çmimeve për librin më të mirë shqip dhe përkthimit të librave më përfaqësues në gjuhë të tjera.

## Trashëgimia kulturore

Çdo popull është i rrënjësuar në forma të prekshme dhe të paprekshme të asaj që njihet si trashëgimia kulturore e tij, shprehja dhe interpretimi i së cilës përbën esencën e kujtesës kolektive të një populli dhe disa prej bazave mbi kuptimin për formimin e identitetit të tij. **Ruajtja e kësaj trashëgimie kulturore është një përgjegjësi tepër e rëndësishme** e gjithë shoqërisë, e në veçanti e institucioneve shtetërore, ndaj brezit të sotëm dhe brezave të ardhshëm që do të vijnë.

Trashëgimia kulturore është e pandashme nga historia e të gjithë popullit të Republikës së Kosovës dhe ajo përbën një thesar dëshmues të krijimtarisë së popullit. Të gjitha objektet e kategorizuara si monumente historiko-kulturore dhe ato që do të kategorizohen si të tilla në të ardhmen, pavarësisht pronësisë së tyre aktuale formale, **janë pjesë e publike së popullit tonë**. Lëvizja VETËVENDOSJE! **do të hartojë kuadrin ligjor për identifikimin, kategorizimin, mbrojtjen dhe konservimin** e të gjithë trashëgimisë kulturore të Republikës

së Kosovës, duke u mbështetur gjithashtu edhe mbi parimet e shprehura në dokumente ndërkombëtare si Karta e Venecias e vitit 1964 dhe Dokumenti i Narës mbi Autenticitetin.

Qasja në burimet e trashëgimisë duhet të jetë e lehtë dhe e barabartë për të gjithë, duke gjetur ekuilibrin më të përshtatshëm mes të drejtës për qasje në këto burime dhe respektimit të nevojave për konservimin, sigurinë dhe funksionin e burimit të trashëgimisë.

Deputetët e koalicionit qeverisës në Kuvendin e Kosovës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) kanë sabotuar me qëllim punën e institucioneve mbikëqyrëse dhe rregulluese. Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës ka dalë jashtë funksionit. KKTK do të shërbejë si një organ që bën verifikimin e inventarit të Listës së Trashëgimisë, si dhe përcaktimin e prioriteteve, duke marrë për bazë propozimet e MKRS. KKTK për më tepër do të ketë brenda saj edhe një tjetër këshill të veçantë për hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave të menaxhimit të vendndodhjeve (siteve) të Republikës së Kosovës që janë tashmë të emëruara në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si dhe për përgatitjen e aplikimeve të reja për emërimë në listat e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Do të ngrihen **padi ndaj të gjithë atyre zyrtarëve dhe kompanive private që kanë shkatërruar objekte të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës. Trashëgimia kulturore nuk është një barrë financiare por një** aset ekonomik që i shërben zhvillimit ekonomik të vendit. Si prioritet buxheti i shtetit për menaxhim të trashëgimisë kulturore do të rritet me 100% deri në fund të vitit të parë qeverisës.

Do të përditësohet **lista e Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Kosovës**. Në këtë listë do të dallohen veçmas të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente me ç'rast duhet bërë konsolidimi parandalues ndaj shkatërrimit.

Do të bëhet kërkesa dhe kushtëzimi i shtetit të Serbisë për të **kthyer në Republikën e Kosovës fondin e artefakteve të trashëgimisë kulturore** dhe arkivat e dokumentimit të trashëgimisë.



Në krye të mandatit të parë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe institucionet shtetërore të Menaxhimit të Trashëgimisë, **trashëgimia kulturore do të përfshihet në mënyrë përmbajtësore në programet shkollore** të planifikimit urban, arkitekturës, turizmit, edukatës qytetare, mbrojtjes së mjedisit, historisë, arkeologjisë, etnologjisë, muzikës dhe arteve pamore sipas niveleve të ndryshme arsimore.

Do të **funksionalizohet Qendra e Trashëgimisë Kulturore** 'Beledie' në qytetin e Prizrenit si një qendër nën menaxhimin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë së Kulturës për përgatitjen profesionale dhe licensimin e: ciceronëve (guidave) turistike të licencuar nga shteti i Kosovës, konservuesve të artit, dhe kurseve të tjera të formimit profesional në fushën e konservimit të trashëgimisë.

Do të themelohen njësitë menaxhuese të siteve historiko-kulturore dhe do të vendoset sistemi i biletarisë në mënyrë që të ngrihen fonde për vetëfinancimin e menaxhimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Do të përafrohet legjislacioni me Republikën e Shqipërisë dhe të iniciohen projekte të përbashkëta kërkimore në fushën e trashëgimisë kulturore.

Lëvizja VETËVENDOSJE konsideron se Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (2008) sipas Planit të Ahtisaarit; Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit (2012); dhe Ligji për fshatin e Hoçës së Madhe në Rahovec (2012) **duhet të riformulohen në përputhje me kushtetutën e re që do të shkruhet për Republikën e Kosovës, duke respektuar parimet e sekularitetit shtetëror, sovranitetit dhe integritetit territorial** si dhe kartat dhe konventat ndërkombëtare për menaxhimi e trashëgimisë kulturore.

Do të **hiqet e drejta e vetos** mbi vendimet për menaxhimin e burimeve të trashëgimisë nga cilado bashkësi fetare. Republika e Kosovës **do të aplikojë si shtet anëtar në UNESCO** me të drejta të plota dhe do të ndryshohet statusi aktual të 'Monumenteve Mesjetare në Kosovë' si monumente kulture pjesë të trashëgimisë kulturore të

Republikës së Kosovës. Do të përgatitet aplikimi i siteve të reja të cilat kanë potencialin të emërohen në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, duke ia nisur nga Qendra Historike e Prizrenit.



## 19. Mjedisi dhe planifikimi hapësinor

Mjedisi është një e **drejtë humane dhe një vlerë e përbashkët**. Çdo gjë që siguron natyra duhet të trajtohet si vlerë e përbashkët. Mbrojtja e këtyre vlerave të përbashkëta është pjesë e përgjegjësiave ekologjike të Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Lëvizja VETËVENDOSJE! do të përmirësojë infrastrukturën ligjore për mbrojtjen e ambientit dhe ngritjen e nivelit të zbatimi të saj. Angazhohemi për **masa rigorozë ligjore** për t'iu kundërvënë dëmtimit të mjedisit.

**Furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm**, ruajtja e ujit nga keqpërdoruesit dhe trajtimi i ujërave të ndotur janë prioritet për Lëvizjen. Siç është potencuar edhe në kapitullin për energji, është e domosdoshme përkrahja e përdorimit të **energjisë alternative të ripërtëritshme** (solare, me erë, riciklim, etj).

Do të ndërmerren masa për zvogëlimin e **emetimit të substancave dhe gazrave të dëmshme nga burimet e tyre** (industria, automjetet etj.). **Mbrojtja e pyjeve dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshur**, pastrimi dhe mbrojtja e lumenjve dhe ndalimi i gërmimit të shtratit të lumenjve do të bëhen që në mandatin e parë qeverisës. Do

të funksionalizohet plani hapësinor në funksion të konceptit për **zhvillim të qëndrueshëm ekonomik**. Do ti kushtohet vëmendje e posaçme dhe kujdes për **parqet nacionale dhe pjesët tjera të natyrës të cilat nuk janë nën mbrojtje të ligjit**. Do të krijohen deponi sipas standardeve ndërkombëtare dhe trajtimi i riciklimi i hedhurinave.

Do të prodhohen **kulturat bujqësore ekologjike** dhe do të kundërshtohen prodhimeve ushqimore gjenetikisht të modifikuara. Prioritet do të jetë edhe hartimi i planit të përgjithshëm hapësinor të Kosovës, **rregullimi i mirëfilltë urban i qyteteve** dhe **ndalimi i ndërtimeve ilegale** si dhe **trajtimi adekuat i objekteve të ndërtuara pa leje**.

Themelimi i mekanizmave monitorues, dhe imponimi i zbatimit të ligjeve për ruajtjen e mjedisit dhe për kontrollin e nivelit të ndotjes do të jenë prioritete për Lëvizjen VETËVENDOSJE!. **Ndaj ndotësve të ambientit nuk do të ketë asnjë tolerancë**. Do të identifikohen instrumentet dhe mekanizma për implementimin e ligjeve për mbrojtjen e ambientit. Por, në të njëjtën kohë, në përputhje me parimin tonë të shtetit të së drejtës, do të penalizohen shkelësit.

Vënia e një **bashkëpunimi ndërministror** në qeverinë e Kosovës është i domosdoshëm. Qëllimi i rritjes së këtij bashkëpunimi ka të bëjë me identifikimin e problemeve në fushat përkatëse si dhe gjetja e sinergjive për zgjidhjen e këtyre problemeve. Planifikimi hapësinor përfshin tërë territorin e një vendi. Kjo do të thotë se secili qytet dhe **secila komunë njëkohësisht duhet të jetë kontributore dhe implementuese e atij plani**.

Toka bujqësore është shkatërruar në Kosovë jashtëzakonisht shumë. Kosova ka pak territor dhe dendësia shënohet ndër më të lartat në Evropë. Këto elemente duhet të jenë arsye të mjaftueshme **që organet kompetente shtetërore të hartojnë planet hapësinore dhe të marrin masa urgjente që ta ruajnë tokën bujqësore** nga ndërtimet dhe ndryshimi i statusit të këtyre tokave. Sipas të dhënave të MBPZHR brenda vitit humbasim rreth 1000 ha. tokë pune. Llogaritet se rreth 400 ha. tokë bujqësore brenda vitit i ndërrohet destinimi i shfrytëzimit në tokë ndërtimore.



## 20. Zhvillimi i sportit

Parimi 'mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë' vijon të konfirmohet si i vërtetë nga mjekësia e shkenca moderne, edhe pse njihet e zbatohet që prej lashtësisë klasike. **Lëvizja VETËVENDOSJE! synon që sporti si aktivitet i përditshëm e i domosdoshëm të bëhet i arritshëm** (përmes investimeve në infrastrukturë) nga të gjithë qytetarët, Sporti si aktivitet garues të zhvillohet në mënyrë të balancuar, duke rritur talentet vendës në shkolla e në institucione, e jo duke u bazuar tek efektet e marketingut global (ardhja e sportistëve të huaj), apo tek përgatitja e talenteve tona nëpër kampionate e liga të huaja.

Lëvizja VETËVENDOSJE! sheh si synim **përfundimtar krijimin e përfaqësueseve të përbashkëta me sportistë shqiptarë nga Shqipëria e Kosova, po ashtu të ligave profesionale të përbashkëta**. Këto do të ishin më dinjitoze, si në përfaqësim ashtu edhe në rezultate. Përveç kësaj, e shohim si të papërputhshme me dëshirën e sportdashësve ekzistencën e ligave apo kombëtareve të ndara. Për këtë arsye, politikat qeverisëse do të fokusohen në ndërtimin dhe zhvillimin e skemave për plotësimin e këtij qëllimi.

Historikisht, Kosova për shkak të diskriminimit të brendshëm në ish Jugosllavi, nuk e ka pasë një infrastrukturë sportive dhe as një pjesëmarrje konkurruese në nivelet e republikave të tjera. Fushat, palestrat, pistat e pishinat apo terrenet e tjera sportive që do të duhet të ekzistonin nëpër lagje të qyteteve e nëpër fshatra, nuk ekzistojnë. Ato që kanë ekzistuar dikur, pjesërisht kanë ndryshuar destinacion, e mbi to janë ndërtuar banesa apo objekte biznesi. Të reja përgjithësisht nuk janë ndërtuar e as nuk janë planifikuar.

Edukimi fizik duhet të jetë universal. Edukimi fizik përcjell vlera të domosdoshme për shoqërinë. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet **të zgjerojë terrenet sportive të shkollave**, të përmirësojë ciklin e përgatitjes pedagogjike për arsimtarët e edukimit fizik, dhe po ashtu që ish-sportistët që mbyllin karrierën e tyre profesionale, të angazhohen në fakultetin e edukimit **fizik** dhe më vonë në mësimdhënie.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që të lidhen klubet dhe shoqatat sportive me shkolla të caktuara, me të cilat ndajnë të njëjtin territor gjeografik. Lëvizja VETËVENDOSJE! mendon se sporti nuk duhet kufizuar vetëm tek zhvillimi i ligave protagoniste e profesionale, apo vetëm tek talentet më të spikatura.

Qendrat sociale dhe socio-kulturore do të ofrojnë **terrene të përshtatshme për të organizuar aktivitete sportive në komunitetet ku shërbejnë**. MKRS do të ndajë një pjesë të buxhetit të saj vjetor për organizimin e aktiviteteve sportive jo-profesionale, në të gjithë republikën.

VETËVENDOSJE! angazhohet për konfirmimin e **pavarësisë së federatave dhe klubeve amatore e profesioniste** brenda kuadrit ligjor dhe sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Federatat dhe shoqatat amatore do të mund të jenë rajonale dhe kombëtare. Federatat profesionale do të jenë kombëtare.

Në dy vitet e para të qeverisjes së Lëvizjes VETËVENDOSJE! do të identifikohen nevojat dhe mundësitë për zhvillimin e infrastrukturës, në bashkëpunim të ngushtë dhe të pandashëm me federatat, komunitetin e sportistëve dhe të sportdashësve. Prioritet zhvillimor në

investimet për infrastrukturë do të marrin ekipet e moshave të reja, si dhe terrenet e lojës. Do të synohet ndërtimi i fushave cilësore, përpara se të synohet ndërtimi i stadiumeve masive. Do të bashkëpunohet me Federatat e Kosovës, të Shqipërisë, dhe ato ndërkombëtare, për ndërtimin e një akademie sportive dhe të një kompleksi olimpik në Kosovë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! në alternativën e saj qeverisëse parashikon **që tri klube sportive të Kosovës do të pajisen me akademi shumësportëshe**. Në këto klube do të krijohen ekipet e moshave, sipas standardeve të njohura. Fëmijët dhe të rinjtë që përzgjidhen, do të marrin bursë shtetërore dhe do të vendosen pranë akademive sportive që të vazhdojnë përgatitjen e tyre. **Do të përgatiten trajnerë dhe mësues të rinj, që do të japin mësim në klasat sportive të këtyre akademive**. Sportet olimpike do të trajtohen me prioritet në programet përgatitore për talentet e reja.

Kampionatet dhe strukturat garuese të sporteve të ndryshme do të rregullohen prej federatave dhe shoqatave respektive. Ato do të pastrohen prej manipulimeve, shitblerjeve, apo paligjshmërive dhe kundërvajtjeve të tjera. Së bashku me federatat do të zhvillohen planet strategjike për ngritjen e nivelit të kampionateve dhe strukturave garuese. Këto plane strategjike do të parashikojnë shpenzime të shpërndara në një periudhë afatmesme, që të mos e ngarkojnë buxhetin shtetëror.

Me anëtarësimin e Kosovës në federata ndërkombëtare, menjëherë do të kërkohet **bashkimi i kampionateve me Shqipërinë**. Në rast se Kosova nuk pranohet të njihet prej federatave ndërkombëtare, atëherë do të gjenden mënyrat që federatat e Kosovës të shkrihen me ato të Shqipërisë, si dhe do të ndiqen rrugët e lobimit në organizmat ndërkombëtarë. **Organizimi i kampionateve të përbashkëta në Shqipëri e Kosovë do të krijonte hapësirën garuese e kompetitive**, si dhe do të sillte më shumë interes nga ana e investitorëve dhe e sportdashësve, në mënyrë që të ketë rritje përgjithësisht edhe niveli sportiv në vend. Shembuj për bashkime të tilla kampionatesh ka edhe në vende të tjera të botës.

Ne i qëndrojmë besimit se ekipet kombëtare, që të jenë përfaqësuese dinjitoze, duhet të jenë të përbashkëta. Detyrë e MKRS në qeverisjen e Lëvizjes VETËVENDOSJE! është që, së bashku me përfaqësuesit e qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të hartojnë një program të qartë, të drejtpërdrejtë e transparent mbi rrugët dhe strategjitë që do të ndiqen, gjersa kjo të bëhet realitet.